



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 460, datë 25.07.2023

**PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT TË KOMANDUAR
NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR Z. {...}
PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-01.06.2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 68, 89 e vijues të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:
 - A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

PASQYRIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSIA PROFESIONALE

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të dokumentave të hartuar, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë punën e gjyqtarit të komanduar dhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit. Aftësia profesionale e gjyqtarit të komanduar pikëzohet, sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë;

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor; Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Referuar “Raportit përshkrues vjetor të punës”, rezulton se gjyqtari i komanduar gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjëse pranë Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve, *përgjatë periudhës 01.01.2019-01.06.2020, ka përgatitur gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) projekt-raporte të analizimit të aftësive profesionale për 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë, nga të cilët 10 (dhjetë) raporte ju përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të apeleve dhe 9 (nëntë) raporte të tjera ju përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të shkallës së parë. Përgatitja e Projekt-raporteve është kryer në respektim të parashikimeve të: Ligjit Nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me përcaktimet e Rregullores: "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional dhe të Aneksëve si pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje, akt i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 24, datë 07.02.2019. N hartimin e projekt-raporteve profesionale të subjekteve të rivlerësimit,*

para hyrjes në fuqi të Rregullores së miratuar nga KLGJ-ja me Vendimin Nr. 24, datë 07.02.2019, ka ndjekur dhe zbatuar formatin standard, kushtet dhe kriteret e parashikuara në Vendimin Nr. 49, datë 16.10.2017, të miratuar nga Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Hartimi i projekt-raporteve për subjektet e rivlerësimit (gjyqtarët), është një proces që ndjek rigorozisht hapat e përcaktuar në Aneksin 1 të Rregullores. Fillimisht, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor për subjektet që do i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar dhe në bashkëpunim me KLGJ-në, planifikohet data e shortit për përzgjedhjen e 5 (pesë) dosjeve gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 08.10.2013-08.10.2016. Nëpunësi përgjegjës merr pjesë në procedurën e shortit dhe asiston Anëtarin e Komisionit të Përkohshëm.

Hartimi i projekt-raportit është bazuar detyrimisht tek burimet e vlerësimit profesional, të përcaktuara në nenin 42 të Ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve....”.

Kështu në raport përfshihet analiza e të dhënave të Formularit të Vetvlerësimit dhe (3) tre dokumentave të paraqitura nga vet subjekti i rivlerësimit, por edhe çdo dokument tjetër i paraqitur prej tij.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”,** lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se ; Rezulton se nëpunësi përgjegjës {...}, në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale për 19 (nëntëmbëdhjetë) subjektet e rivlerësimit, ka mbajtur në konsideratë “burimet” për rivlerësimin e e aftësisë profesionale të parashikuara në nenin 42, pika 1, të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe “burimet” e parashikuara në nenin 12 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve” të sipërcituar. Në zbatim të sa më sipër, nëpunësi përgjegjës analizon të dhënat bazuar në (i) formularin e vetvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ (mbi subjektin e rivlerësimit). Në vlerësimin e aftësisë profesionale dhe etike të subjekteve të rivlerësimit ka zbatuar me përpikmëri dispozitat e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për aq sa ky ligj ishte i mundshëm për tu zbatuar në këtë proces rivlerësimi. Në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit (gjyqtarë), ka respektuar detyrimin e parashikuar **në nenin 72 pika 4 të Ligjit nr. 96/2016** të sipërcituar, në të cilin thuhet: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”. Në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit (gjyqtarë), ka respektuar pavarësinë e tyre të garantuar nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi.

Në përfundim, lidhur me këtë tregues Struktura Përgjegjëse Organizative konkludon se: Rezulton se nëpunësi përgjegjës {...}, në procesin që shoqëron hartimin e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, ka treguar aftësi shumë të mira për të identifikuar shpejt dhe saktë natyrën e çështjes që i caktohet për trajtim; hapat që duhet të ndiqen për kryerjen e detyrës që i ngarkohet, si dhe normat konkrete materiale dhe/ose procedurale që duhen zbatuar në çështjen objekt shqyrtimi. Shfrytëzon më së miri, burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke u shprehur se është dakord dhe nuk ka kundërshtime për vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative, dhe konkluduar se; *Bazuar sa më sipër, konstatohet se në të gjitha detyrat e kryera prej meje në cilësinë e gjyqtarit të komanduar, kam treguar aftësi të larta për të identifikuar saktë dhe shpejt natyrën e çështjes të caktuar për trajtim, hapat që duhen ndjekur për kryerjen e detyrës që më është ngarkuar, si dhe normat konkrete materiale dhe/ ose procedurale që duhen zbatuar në çështjen objekt shqyrtimi.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtari i komanduar Z. {...}, nëpunës përgjegjës në Njësinë Mbështetëse për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve¹, gjatë periudhës së vlerësimit, ka përfunduar hartimin e projektraportit të analizimit të aftësisë profesionale për 19 (nëntëmbëdhjetë) subjekte të rivlerësimit (nga të cilët 10 raporte ju përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të apeleve dhe 9 raporte të tjera ju përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të shkallës së parë). Gjyqtari i komanduar, në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, ka mbajtur në konsideratë “burimet” për rivlerësimin e e aftësisë profesionale të parashikuara në nenin 42, pika 1, të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe “burimet” e parashikuara në nenin 12 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve”². Në hartimin e projektraporteve, nëpunësi përgjegjës analizon të dhënat bazuar në (i) formularin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ (mbi subjektin e rivlerësimit).

Nga burimet e vlerësimit rezulton se, krahas kushteve dhe kriterëve të përgjithme të vlerësimit profesional dhe etik, për secilin gjyqtar në varësi të shkallës së gjykimit, në varësi të juridiksionit gjyqësor, gjyqtari i komanduar zbaton edhe kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjet specifike që rregullojnë veprimtarinë e gjykatës ku ushtron veprimtarinë gjyqtari, si psh parashikimet e ligjit Nr. 9110, dt. 24.07.2003 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Për Krime të Rënda”, ligjit Nr. 10192, dt. 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe ligjit Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Në respektim të strukturës së projektraportit, paraqet dhe rendit faktet që rezultojnë nga dokumentet që përbëjnë burim vlerësimi duke analizuar kështu aftësitë profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit të cilat përbëjnë objektin e vlerësimit, duke u ndaluar vetëm

¹ Njësi që asiston Komisionin e Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve, që u ngrit në bazë të Vendimit Nr. 15, datë 22.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njësia Mbështetëse përbëhet nga Nëpunësit Përgjegjës të cilët janë gjyqtarë të komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nëpunësit përgjegjës pasi caktohen me short, ngarkohen të hartojnë Projektraportin e analizimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit (gjyqtar ose ndihmës/këshilltarë ligjorë).

² Miratuar me Vendimin Nr. 24, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

në elementë të vlerësimit që janë të rëndësishme dhe domethënëse dhe duke shmangur elementët e panevojshëm apo të tepërt.

Z. {...} ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor, në tetë procese gjyqësore³. Në këto procese gjyqësore, në cilësinë e përfaqësuesit të palës së paditur, ka identifikuar saktë pretendimet e palës paditëse dhe argumentet kundërshtuese të saj në lidhje me vendimmarrjen e Këshillit objekt shqyrtimi gjyqësor. Gjithashtu gjyqtari i komanduar ka evidentuar saktë përmbajtjen e vendimit të Këshillit objekt ankimi, ka përgatitur prapësimet dhe argumentet kundërshtuese ndaj padisë, si dhe ka përgatitur konkluzionet përfundimtare. Në këto procese gjyqësore, ka patur të qartë natyrën e pretendimeve të palës paditëse, duke dhënë përgjigje ligjore për këto pretendime, në funksion të mbrojtjes së vendimmarrjes së Këshillit.

Z. {...} edhe në rastin e urdhrave të tjerë të nxjerrë nga titullari i Këshillit, ka patur të qartë objektin e punës që duhej të kryente, natyrën e çështjes, si dhe ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien objekt trajtimi.

Nga analiza e të dhënave⁴ rezulton se gjyqtari i komanduar {...}, ka respektuar pavarësinë e subjekteve të rivlerësimit të garantuar nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, në vlerësimin e aftësisë profesionale të tyre. Gjyqtari i komanduar, në hartimin dhe përgatitjen e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale për 19 (nëntëmbëdhjetë) subjektet e rivlerësimit, ka zbatuar me përpikmëri kriteret e vlerësimit profesional dhe etik të përcaktuara nga Sistemi i Vlerësimit në Fuqi, në periudhën kohore që përfshin procesi i rivlerësimit kalimtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka aftësi shumë të mira për të shqyrtuar dhe përpunuar në mënyre tërësore burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore, për të përcaktuar elementët faktikë të çështjes për trajtim, për të identifikuar natyrën e saj, çështjet që shtrohen për zgjidhje, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se shkalla e aftësisë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave është shumë e lartë dhe pikëzohet me 25 pikë.*

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin

³ Raporti Përshkrues i Punës Nr. 2780 prot., datë 08.05.2023

⁴ Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se; *Ka rezultuar se nëpunësi përgjegjës {...}, në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive për 19 (nëntëmbëdhjetë) subjektet e rivlerësimit (gjyqtarë të shkallës së parë dhe atyre të apelit), ka zbatuar rigorozisht formatin standart të projekt-raportit në përputhje me parashikimet e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, e miratuar me vendimin nr. 24, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të Aneksëve pjesë përbërëse e saj.*

Gjatë hartimit të projekt-raporteve të analizimit të aftësive për 19 (nëntëmbëdhjetë) subjektet e rivlerësimit, ka rezultuar se nëpunësi përgjegjës {...}, ka ndjekur rigorozisht procedurën ligjore të mëposhtme:

Në respektim të parashikimit të nenit 42 pika 3 të Ligjit nr. 84/2016, në projektraport, ka përshkruar saktësisht dhe plotësisht, të dhënat e pasqyruara nga subjekti i rivlerësimit në Formularin e Vetëvlerësimit Profesional. Nëpunësi përgjegjës, ka vlerësuar nëse formulari i vetëvlerësimit, është plotësuar sipas formës standarde, të parashikuar në shtojcën 4 bashkëlidhur Ligjit nr. 84/2016. *Më tej, nëpunësi përgjegjës, ka vijuar analizën ligjore për 3 (tre) dokumentat e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit (gjyqtar), të cilat zakonisht përfaqësojnë 3(tre) vendime gjyqësore të dhëna prej tij. Në lidhje me 3 (tre) vendimet e prezantuara, nëpunësi përgjegjës, analizon saktë mënyrën e zgjidhjes së çështjes prej subjektit të rivlerësimit në raport me qëndrimin që kanë mbajtur gjykatat më të larta, në rastin kur vendimi i është nështruar kontrollit nga këto gjykata.*

Vlerëson mënyrën se si janë çmuar dhe vlerësuar provat nga gjyqtari, interpretimi dhe zbatimi i ligjit material nga gjyqtari në funksion të dhënies përgjigje të pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve.

Vlerëson gjithashtu, nëse vendimi është arsyetuar nga gjyqtari në përputhje me standartet e arsyesimit të vendimit të përcaktuara në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të R.SH-së, si dhe në Jurisprudencën e GJEDNJ-së”.

Në vijim, në projektraport, nëpunësi përgjegjës, vazhdon analizën profesionale në lidhje me 5(pesë) dosjet e përzgjedhura me short sipas një sistemi rastësor. Në lidhje me 5 (pesë) dosjet e përzgjedhura nëpunësi përgjegjës ka vlerësuar saktësisht aspektet e mëposhtme:- Kohëzgjatjen e gjykimit, numrin e seancave të zhvilluara, shkaqet e shtyrjes së seancave nëse janë të justifikuara ose jo, veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari pas marrjes së çështjes me short, të tilla si: planifikimi i seancës përgatitore/ të pajtimit apo gjyqësore në

varësi të llojit të çështjes (penale, civile, administrative, familjare etj); nëse janë respektuar afatet ligjore procedurale për vënien në lëvizje të çështjes; vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të kryer veprime të shpejta dhe efikase, për të shmangur vonesat e panevojshme si dhe për të përfunduar gjykimin në respektim të afatit ligjor apo afatit standard, të paracaktuar nga Sistemi i Vlerësimit në fuqi në periudhën 08.10.2013-08.10.2016 (periudha e parashikuar nga neni 41/3 i ligjit nr. 84/2016).

Nëse gjykimi është përfunduar në shkelje të afatit ligjor apo standard, duke vlerësuar sjelljen e gjyqtarit, sjelljen e palëve ndërgjyqëse, kompleksitetin e çështjes, por edhe faktorë të tjerë që mund të kenë ndikuar në tejkalimin e afatit. Aftësinë e gjyqtarit për të interpretuar dhe zbatuar ligjin procedural në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor sipas detyrimit që buron nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe legjislacioni procedural në fuqi. Aftësinë e gjyqtarit për të interpretuar dhe zbatuar ligjin material në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel. Nëse është ankimuar vendimi vlerësohet nëse ai është lënë në fuqi apo është çënuar nga gjykatat më të larta. Nëse është çënuar vendimi listohen shkaqet, arsyet e çënimit nga gjykata më e lartë, mbahet në konsideratë nëse vendimi u çënuar për shkelje procedurale, për zbatim të gabuar të ligjit material apo për vlerësim të gabuar të provave. Vlerësohet, nëse vendimi gjyqësor i dhënë në përfundim të gjykimit përmbush standardet e arsytimit, si dhe aftësinë e gjyqtarit për të njohur apo për të referuar sipas rastit, në Jurisprudencën Unifikuese të Gjykatës së Lartë, njohjen e Jurisprudencës të Gjykatës Kushtetuese, si dhe njohjen e Jurisprudencës së GJEDNJ-së etj. Nëse vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretari i zbardhur brenda afatit ligjor apo në tejkalim të këtij afati.

Në aspektin organizativ të punës së gjyqtarit, vlerëson aftësinë e tij për të përballuar volumin e punës që i caktohet, si dhe nëse ka përmbushur standardin sasior të punës sipas parashikimeve të Sistemit të Vlerësimit.

Në aspektin e sjelljes etike të gjyqtarit, nëpunësi përgjegjës vlerëson sjelljen e gjyqtarit në raport me kolegët, stafin administrativ të gjykatës ku ushtron detyrën, sjelljen etike në raport me pjesëmarrësit në proces, por edhe jashtë procesit gjyqësor. Gjithashtu nëpunësi përgjegjës vlerëson të dhënat që merren nga Burimet Njerëzore të KLGJ-së, por edhe rezultatet e ankesave në adresë të veprimtarisë së gjyqtarit për periudhën 08.10.2013-08.10.2016.

Në lidhje me aspektin e paanshmërisë së gjyqtarit, vlerëson numrin e kërkesave të tij për dorëheqje gjatë gjykimit apo numrin e kërkesave për përjashtimin e tij dhe se çfarë është vendosur në rast të kërkesave për përjashtimin e tij nga gjykimi. Vlerëson gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimit, nëse vërehen fjalë të papërshtatshme apo me karakter denigrues, diskriminues, apo fyes për palët në proces etj. Vlerëson integritetin e gjyqtarit në raport me të dhënat që rezultojnë nga dosja e vlerësimit, por edhe të gjitha të dhënat që sigurohen në kuadër të procesit të rivlerësimit të tij. Vlerëson angazhimin profesional të gjyqtarit, gadishmërinë e tij për thellimin e njohurive profesionale, specializimet, botimet juridike, pjesëmarrjen dhe frekuentimin e trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistarturës, por dhe trajnime jashtë këtij programi nëse ka patur gjyqtari përkatës etj.

Lidhur me këtë tregues, struktura përgjegjëse organizative e ka vlerësuar gjyqtarin maksimalisht, duke konkluduar se; *Nëpunësi përgjegjës {...}, ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në procesin, për hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Nëpunësi përgjegjës, analizon saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, çdo aspekt të veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarit që vlerëson. Nëpunësi përgjegjës {...}, arsyeton qartë mënyrën e zbatimit të ligjit në çështjet e trajtuara, dhe siguron lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitave ligjore të zbatuara me faktet e rezultuara. Nëpunësi përgjegjës {...}, zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, të cilat kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjeve të trajtuara prej tij. Nëpunësi përgjegjës {...}, në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, mban gjithnjë në konsideratë Jursiprudencën e Gjykatave më të larta, veçanërisht Jursiprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudence të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si dhe Jurisprudence Unifikuese të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar njëloj si struktura përgjegjëse organizative dhe duke mos pasur kundërshtime për vlerësimin lidhur me këtë tregues. Konkretisht gjyqtari ka konkluduar se; *Në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, kam manifestuar aftësi të larta në interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Kam analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, çdo aspekt të veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarit subjekt vlerësimi. Kam arsyetuar qartë mënyrën e zbatimit të ligjit në çështjet e trajtuara prej meje, duke siguruar lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitave ligjore të zbatuara me faktet e rezultuara. Në rastet kur ka qënë e nevojshme, kam referuar dhe zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, të cilat kishin lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes objekt trajtimi. Kam mbajtur gjithnjë në konsideratë në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, Jurisprudence të Gjykatave më të larta në respektim të parimit të pavarësisë së gjyqësorit, veçanërisht Jurisprudence të GJEDNJ-së, Jurisprudence të GJ.K të R.SH-së, si dhe Jurisprudence Unifikuese të Gjykatës së Lartë të R.SH-së. Gjithashtu, në çështjet e tjera që më janë ngarkuar për të zgjidhur, kam shfaqur aftësi të larta në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm, në funksion të trajtimit dhe zgjidhjes së drejtë të tyre.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtari i komanduar Z. {...} në hartimin e projektraporteve është fokusuar në analizën e burimeve të vlerësimit (Formulari i Vetëvlerësimit, tre dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short prej tij). Veçanërisht, gjyqtari paraqet në mënyrë të hollësishme dhe analizon të dhënat e rezultuara nga 5 dosjet e përzgjedhura, ku shikon kohëzgjatjen e gjykimit, respektimin e afateve standarde dhe afateve ligjore të gjykimit të çështjes, sjelljen e gjyqtarit me palët dhe të tretët gjatë procesit, vlerëson arsyetimin e vendimit dhe nëse është respektuar afati ligjor i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretarinë e gjykatës përkatëse etj.

Në analizën që i bën burimeve të të dhënave, gjyqtari i komanduar vlerëson aftësinë e gjyqtarit subjekt rivlerësimi kalimtar:

- për të interpretuar dhe zbërthyer kuptimin e ligjit, njohjen prej tij të jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese, Jurisprudenca Unifikuese e Gjykatës së Lartë, etj;
- për të përballuar volumin e punës që i është ngarkuar, aftësitë e tij procedurale për të përfunduar gjykimin brenda afateve të arsyeshme, sjelljen e tij etike në raport me kolegët, stafin administrativ të gjykatës, palët ndërgjyqëse etj;
- për të mbetur i paanshëm duke vlerësuar numrin e kërkesave të tij për dorëheqje gjatë gjykimit apo numri i kërkesave për përjashtimin e tij dhe se çfarë është vendosur në rast të kërkesave për përjashtimin e tij nga gjykimi;
- për të marrë pjesë në aktivitetet trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, por edhe ato të organizuara nga institucione të tjera vendase apo të huaja e etj.

Në hartimin e raportit etik dhe profesional të subjektit të rivlerësimit kalimtar, bazuar në burimet e vlerësimit, gjyqtari i komanduar, ka për detyrë të verifikojë:

- kohëzgjatjen e gjykimit;
- numrin e seancave të zhvilluara;
- shkaqet e shtyrjes së seancave nëse janë të justifikuara ose jo;
- veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari pas marrjes së çështjes me short, të tilla si: planifikimi i seancës përgatitore/ të pajtimit apo gjyqësore në varësi të llojit të çështjes (penale, civile, administrative, familjare etj);
- nëse janë respektuar afatet ligjore procedurale për vënien në lëvizje të çështjes; vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të kryer veprime të shpejta dhe efikase, për të shmangur vonesat e panevojshme si dhe për të përfunduar gjykimin në respektim të afatit ligjor apo afatit standard, të paracaktuar nga Sistemi i Vlerësimit në fuqi në periudhën 08.10.2013-08.10.2016⁵;
- gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimit, nëse vërehen fjalë të papërshtatshme apo me karakter denigrues, diskriminues, apo fyes për palët në proces etj
- kohën kur vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretari i zbardhur, për të përcaktuar më tej nëse është përcaktuar brenda afatit ligjor apo në tejkalim të këtij afati.

Gjatë procesit të punës, gjyqtarit të komanduar {...}, nuk i është kthyer për ripunim, për të meta apo mangësi të aspektit profesional apo gjuhësor, prej relatorit apo nga Komisioni i Përkohshëm Profesional apo prej organeve të Vettingut (Komisionit të Pavarur të Kualifikimit apo Kolegjit të Posaçëm të Apelimit), asnjë nga nëntëmbëdhjetë projektraportet profesionale të subjekteve të rivlerësimit të cituara më lart.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për të evidentuar dhe zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumentave ligjorë, dhe në

⁵ periudhë e parashikuar nga neni 41/3 i ligjit nr. 84/2016

arsyetimet me shkrim ose verbale. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se: *Konstatohet se projektraportet e analizimit të aftësisë profesionale për subjektet e rivlerësimit, të përgatitura nga nëpunësi përgjegjës {...}, janë hartuar me një gjuhë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme. Nga ana e tij, i kushtohet vëmëndja e duhur strukturës formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve. Në të gjitha projektraportet e përgatitura prej tij, ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm dhe është kujdesur në analizën e kontekstit të fjalëve. Paraqet në mënyrë kronologjike çështjet e trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projektraportit. Përdor si duhet konceptet profesionale, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nëndarje dhe paragrafë sipas rastit. Thelbi i detyrës kuptohet saktësisht prej tij. Menaxhon shumë mirë kohën dhe burimet e tjera në funksion të realizimit të afateve kohore, pa anashkaluar saktësinë e veprimeve që duhen kryer. Ka aftësinë e duhur për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale, aktet dhe i përdor ato në funksion të organizimit të punës. Grumbullon në kohë, gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përgatitjes së projektraportve profesionale, si dhe dokumenton saktë çdo veprim të kryer prej tij. Të gjitha projektraportet e përgatitura prej tij, paraqiten të organizuara sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen. Në të gjitha rastet, projektraportet e përgatitura prej tij, janë miratuar nga struktura përgjegjëse organizative pa vërejtje, tregues ky i cilësisë së hartimit të tyre. Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj secilit projektraport, nuk janë konstatuar të meta, dhe në asnjë rast nuk ka patur kthime të raporteve për përmirësim të tyre.*

Në përfundim, lidhur me këtë tregues Struktura Përgjegjëse Organizative konkludon se: *Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se nëpunësi përgjegjës ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve në projektraporte, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e tij, sipas rregullave të përcaktuara, si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke parashtruar se: *Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se në dokumentat e përgatitura prej meje (projektraport profesional, raport verifikimi, raporte/propozime/konkluzione etj), rezultojnë se gjuha e përdorur prej meje është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Kam përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, kam respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte, në funksion të kuptueshmërisë dhe qartësisë së përmbajtjes së tyre. Mënyra e organizimit dhe e shprehjes së mendimit në arsyetimin e dokumenteve ligjore burim vlerësimi dhe përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri-tjetrin, sipas linjës së arsyetimit logjik, i bën dokumentet ligjore lehtësisht të lexueshme dhe të organizuara sipas një vijueshmërie logjike.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezultojnë se në procesin e hartimit të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtari i komanduar {...}, shfaq aftësi të larta për të shprehur mendimin e tij juridik, nëpërmjet përdorimit të fjalëve të shkurtra, të thjeshta, të kuptueshme, logjike, si dhe zbaton saktësisht rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës.

Ai kujdeset që gjuha e përdorur në projektraporte të jetë profesionale, me përdorimin si duhet të termave teknikë profesionale, si dhe duke përdorur të gjitha shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari i komanduar i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të projektraporteve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë, jo vetëm për organet e Vetting-ut por për çdo lexues. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit në çdo nënndarje të projektraportit, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjesë të tij, sipas përmbajtjes. Dokumentet ligjorë të hartuar apo përpunuar nga gjyqtari i komanduar janë të qartë, koncize dhe lehtësisht të kuptueshëm dhe të lexueshëm. Dallohet qartë përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë, zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalëve për të shprehur kuptimin si dhe përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë::

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se: *“Konstatohet se projektraportet e analizimit të aftësisë profesionale për subjektet e rivlerësimit, të përgatitura nga nëpunësi përgjegjës {...}, janë hartuar me një gjuhë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme. Nga ana e tij, i kushtohet vëmëndja e duhur strukturës formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve. Në të gjitha projektraportet e përgatitura prej tij, ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm dhe është kujdesur në analizën e kontekstit të fjalëve. Paraqet në mënyrë kronologjike çështjet e trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projektraportit. Përdor si duhet konceptet profesionale, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nëndarje dhe paragrafë sipas rastit. Thelbi i detyrës kuptohet saktësisht prej tij. Menaxhon shumë mirë kohën dhe burimet e tjera në funksion të realizimit të afateve kohore, pa anashkaluar saktësinë e veprimeve që duhen kryer. Ka aftësinë e duhur për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale, aktet dhe i përdor ato në funksion të organizimit të punës. Grumbullon në kohë, gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përgatitjes së projektraportve profesionale, si dhe dokumenton saktë çdo veprim të kryer prej tij. Të gjitha projektraportet e përgatitura prej tij, paraqiten të organizuara sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen. Në të gjitha rastet, projektraportet e përgatitura prej tij, janë miratuar nga struktura përgjegjëse organizative pa vërejtje, tregues ky i cilësisë së hartimit të tyre. Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj secilit projektraport, nuk janë konstatuar të meta, dhe në asnjë rast nuk ka patur kthime të raporteve për përmirësim të tyre.”*

Në përfundim struktura përgjegjëse organizative, duke e vlerësuar aftësinë e gjyqtarit si shumë të lartë, ka konkluduar se; *Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se nëpunësi përgjegjës ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve në*

projektraporte, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e tij, sipas rregullave të përcaktuara, si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se: *“Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se në cilësinë e gjyqtarit të komanduar, kam shfaqur aftësi të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirorganizuar të dokumentit ligjor, pavarësiht përmbajtjes që ka secila pjesë e tij. Në të gjitha dokumentet ligjore të përgatitura prej meje,, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë, dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike e rrjedhshmërisë së mëndimit juridik, nga njëra pjesë e dokumentit tek tjetra, orienton drejt dhe saktë lexuesin. Kam zbatuar me përpikmëri rregullat për shkrimin dhe arsyetimin ligjor, duke përdorur një metodë të qartë në strukturimin e dokumentit të përgatitur prej meje, sipas rregullave të përcaktuara, si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtje të tij”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar {...} i kushton vëmëndjen e duhur strukturës formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve.

Në të gjitha projektraportet e përgatitura prej tij, ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm dhe është kujdesur në analizën e kontekstit të fjalëve.

Gjithashtu rezulton se ai paraqet në mënyrë kronologjike çështjet e trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projektraportit. Përdor si duhet konceptet profesionale, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nëndarje dhe paragrafë sipas rastit.

Gjyqtari i komanduar menaxhon shumë mirë kohën dhe burimet e tjera në funksion të realizimit të afateve kohore, pa anashkaluar saktësinë e veprimeve që duhen kryer si dhe ka aftësinë e duhur për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale, aktet dhe i përdor ato në funksion të organizimit të punës.

Gjatë procesit të hartimit të projektraporteve, gjyqtari ka grumbulluar në kohë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përgatitjes së tyre, si dhe ka dokumentuar saktë çdo veprim të kryer prej tij.

Rezulton se të gjitha projektraportet e përgatitura prej tij, paraqiten të organizuara sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen si dhe në të gjitha rastet, janë miratuar nga struktura përgjegjëse organizative pa vërejtje, tregues ky i cilësisë së hartimit të tyre.

Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj secilit projektraport, nuk janë konstatuar të meta, dhe në asnjë rast nuk ka patur kthime të raporteve për përmirësim të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari i komanduar ka aftësi shumë të larta për të mbajtur një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirëorganizuar, në dokumentet ligjorë të hartuar/përpunuar prej tij, strukturë të cilës gjyqtari i komanduar i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit. Ai ndjek një metodologji të caktuar sipas pjesëve përbërëse të projektraporteve, apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Gjyqtarit të komanduar nuk i është kthyer asnjë dokument ligjorë nga strukturës përgjegjëse organizative për shkak të gabimeve materiale apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo strukturën e dakordësuar më parë, sipas rastit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit të komanduar në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se: *“Në përmbajtjen e projektraporteve të analizimit të aftësisë profesionale dhe etike, konstatohet qartë se nëpunësi përgjegjës {...}, i kushton vëmëndjen e duhur lidhjes logjike midis fakteve dhe çështjeve objekt analize dhe përfundimeve të arritura. Argumentimi ligjor mbi çështjet e trajtuara, ka përfshirë koncepte, institute juridike, por edhe parime të së drejtës, për aq sa ato kanë patur lidhje me thelbin dhe natyrën e çështjes objekt trajtimi. Gjatë analizës që i bëhet normës juridike, nëpunësi përgjegjës zbërthen kuptimin e saj dhe sqaron lidhjen e saj me çështjen objekt trajtimi. Në asnjë rast, Komisioni nuk kthyer për ripunim projektraportet e hartuara prej tij, për mangësi në argumentimin ligjor apo për arsye të mungesës logjike midis analizës së fakteve dhe përfundimit të arritur.”*

Në përfundim struktura përgjegjëse organizative, duke e vlerësuar aftësinë e gjyqtarit si shumë të lartë, ka konkluduar se; *Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nëpunësi përgjegjës ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Ai analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjes objekt analize,*

mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Nëpunësi përgjegjës e zhvillon argumentimin e tij duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen mes tyre.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke parashtruar se: *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se kam treguar kujdes të veçantë në analizimin e qartë të fakteve thelbësore të çështjes që lidhet me vlerësimin e aftësisë profesionale dhe etike të subjekteve të rivlerësimit, duke i analizuar ato në mënyrë të përmbledhur në çështjet jokomplekse dhe në rastet komplekse në mënyrë të detajuar, por në çdo rast në mënyrë logjike dhe të kuptueshme. Analiza e çështjeve ligjore të trajtuara nga unë është kryer duke integruar analizën ligjore të legjislacionit të zbatueshëm për ato çështje, në shërbim të konkluzionit të arritur në përfundim të trajtimit të çështjes. Nga tërësia e dokumentave objket vlerësimi rezulton se dokumentet ligjore të hartuara prej meje, së bashku me vlerësimin e kryer dhe rezultatet e konstatuara, janë mbështetur dhe nuk janë kthyer asnjëherë nga strukturat kompetente të Këshillit, tregues ky i cilësisë së lartë dhe argumentimit logjik si dhe mendimit juridik të mbështetur dhe argumentuar ligjërisht”.*

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në përmbajtjen e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale dhe etike, konstatohet qartë se gjyqtari i komanduar {...}, i kushton vëmendjen e duhur lidhjes logjike midis fakteve dhe çështjeve objekt analize dhe përfundimeve të arritura. Në argumentimin e tij ligjor mbi çështjet e trajtuara, ka përfshirë koncepte, institute juridike, por edhe parime të së drejtës, për aq sa ato kanë patur lidhje me thelbin dhe natyrën e çështjes objekt trajtimi. Gjatë analizës që i bëhet normës juridike, gjyqtari i komanduar zbërthen kuptimin e saj dhe sqaron lidhjen e saj me çështjen objekt trajtimi.

Në asnjë rast, Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve (struktura përgjegjëse organizative) nuk i ka kthyer për ripunim projektraportet e hartuara prej tij, për mangësi në argumentimin ligjor apo për arsye të mungesës logjike midis analizës së fakteve dhe përfundimit të arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre vlerësohet se cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore në dokumentet ligjorë të hartuar apo përpunuar nga gjyqtari është e lartë. Gjyqtarit i komanduar ka aftësinë për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim. Në asnjë rast nuk i janë kthyer projektraportet nga struktura përgjegjëse organizative për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit të komanduar për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSIA PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat pjesë e punës në Këshill. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a Aftësia për të realizuar volumin normal të punës

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkruar vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Referuar “Raportit përshkruar vjetor të punës”, rezulton se gjyqtari e komanduar gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunëses përgjegjëse pranë Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etiko dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve ka hartuar 19 (nëntëmbëdhjetë) projektraporte standarde të analizimit të aftësive profesionale për 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë nga të cilët 10 (dhjetë) projektraporte u përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të apelit dhe 9 (nëntë) projektraporte u përkasin gjyqtarë të gjykatave të shkallës së

parë. Gjithashtu, si pjesë e detyrës funksionale sipas pozicionit të komandimit, në zbatim edhe të Rregullores së miratuar nga KLGJ, ka marrë pjesë në të gjitha shortet e organizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në bashkëpunim me Komisionin përkatës në Këshillin e Lartë Gjyqësor për përzgjedhjen e 5 (pesë) dosjeve me short në funksion të hartimit të projektraporteve për subjektet e rivlerësimit. Në periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020 përtej detyrave të kryera si nëpunëse përgjegjëse/inspektore në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, me urdhër të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor gjyqtari është ngarkuar me detyra të tjera me natyrë: pjesëmarrje në 2 (dy) grupe pune, përfaqësime në 8 (tetë) procese gjyqësore, si dhe grumbullim informacioni mbi problematika të pretenduara nga subjekte të ndryshme ndaj veprimtarisë së disa kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve si dhe kancelarëve, apo zbatim vendimesh të KLGJ-së.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”,** lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se : *“Nëpunësi përgjegjës {...}, në periudhën objekt i këtij vlerësimi ka përballuar një volum të lartë pune. Në cilësinë e nëpunësit përgjegjës pranë Njësisë Mbështetëse të Komisionit të Përkohshëm, ka përfunduar dhe dorëzuar pranë Komisionit, 19 (nëntëmbëdhjetë) projektraporte të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtarë të shkallëve të para si dhe për gjyqtarë apeli. Përgatitja e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale, është një proces që kërkon realizimin e shumë veprimeve deri në finalizimin e tij. Nëpunësi përgjegjës {...}, ka shfaqur gjithnjë një përkushtim maksimal gjatë procesit të hartimit të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale dhe jo vetëm.*

Kështu, pas marrjes me short të dosjes së rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, nëpunësi përgjegjës, menjëherë, ka verifikuar saktësinë e të dhënave statistikore për çështjet e gjykuara nga subjekti në periudhën 08.10.2013-08.10.2016, të dhëna të dërguara nga gjykata ku ai ka ushtruar funksionin gjatë kësaj periudhe rivlerësimi.

Nëse të dhënat statistikore kanë rezultuar me mangësi, nëpunësi përgjegjës në bashkëpunim të ngushtë me stafin përkatës dhe ndihmës të KLGJ-së, kanë kërkuar nga gjykata respektive ndreqjen e gabimeve në tabelat statistikore duke i ripunuar ato.

Në procesin e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e pesë dosjeve, nëpunësi përgjegjës {...}, ka treguar angazhim maksimal në mbajtjen e saktë të procesverbalit të shortit, por edhe duke u kujdesur që përzgjedhja e pesë dosjeve të kryhet duke respektuar rigorozisht kriteret e përzgjedhjes të parashikuara në Anekset e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”.

Pas hedhjes së shortit nëpunësi përgjegjës është kujdesur në bashkëpunim me stafin ndihmës të këtij procesi, për tërheqjen e pesë dosjeve pranë gjykatave ku ato ndodhen. Pasi janë siguruar dosjet, por edhe të dhënat nga Burimet Njerëzore dhe Arkivore të KLGJ-së, nëpunësi përgjegjës ka vijuar punën për hartimin e projektraportve, ku në varësi të kompleksitetit të çështjeve objekt trajtimi, procesi merr mesatarisht tre deri në katër javë kohë. (ky afat, nga momenti i paraqitjes në Këshill të dosjes së fundit përcjellë nga gjykatat).

Në hartimin e projektraporteve, nëpunësi përgjegjës {...}, ka përgatitur me përparësi dhe në përputhje me udhëzimin e Komisionit, ato që ju përkasin subjekteve, raportet e të cilëve janë kërkuar me urgjencë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Në hartimin e projektraporteve, nëpunësi përgjegjës {...}, ka treguar një përkushtim të lartë, me qëllim që projektraportet profesionale, të përfundohen në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, por kurrësi pa çënuar cilësinë e përmbajtjes së tyre.

Bazuar në Raportin përshkrues statistikor të hartuar nga nëpunësi përgjegjës {...}, rezultoi se ai përveç hartimit të projektraportve profesionale, ka kryer edhe detyra të tjera të cilat i janë ngarkuar atij nga struktura eprore administrative.

Referuar Raportit përshkues së punës të paraqitur nga magjistrati i komanduar, rezultoni se në periudhën e vlerësimit ai ka qenë e ngarkuar nga detyra të tjera të përgjithshme të natyrës verifikim pretendimesh apo zbatim vendimesh të KLGJ-së, duke grumbulluar informacion, akte, marrje shpjegime dhe raportim Kryetares së KLGJ-së mbi rezultatet përkatëse.

Kështu sipas të dhënave të deklaruara prej tij, rezultoni se me urdhër të Kryetares së KLGJ-së ka marrë pjesë në disa verifikime të rasteve të iniciuara nga ankues apo magjistratë për çështje të cilat krijojnë problematika të vlerësuara nga Kryetarja për trajtim. Në përfundim të secilës detyrë të ngarkuar, pas vizitave në terren, grumbullimit të dokumentacionit dhe marrjes së shpjegimeve përkatëse nga subjektet e parashikuara në secilin urdhër, magjistrati ka deklaruar se në bashkëpunim me kolegën e tij, pjesë e grupit të punës, janë hartuar Relacionet respektiv mbi të gjitha të dhënat e evidentuara, si dhe me një analizë ligjore të gjetjeve të konstatuara. Në zbatim të urdhrave të caktuar, secili prej raportëve i është dorëzuar Kryetares së KLGJ-së menjëherë pas përpilimit të tij”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”,** lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtari vlerësohet maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit, dhe situatës faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre, është shprehur aftësi e lartë në respektim të volumit dhe afateve për realizimin e punës, si dhe në aspektin procedural dhe saktësisë”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, ku pasi ka përshkruar volumin e punës së kryer prej tij, ka konkluduar se; *Bazuar në sa më sipër, rezultoni se gjatë periudhës 01.01.2019- 01.06.2020, kam përballuar një volum të lartë pune në cilësinë e gjyqtarit të komanduar pranë KLGJ-së. Kam përmbushur në kohë dhe me cilësi profesionale detyrat që më janë ngarkuar si nga Struktura Përgjegjëse Organizative, ashtu edhe ato të caktuara nga Strukturat më të Larta Administrative të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”*

Në konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi gjyqtari nuk ka bërë komente apo kundërshtime me mendimin e strukturës përgjegjëse organizative dhe administrative të dhënë për këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar {...}, në periudhën objekt i këtij vlerësimi ka përballuar një volum të lartë pune. Ai, në cilësinë e nëpunësit përgjegjës pranë Njësisë Mbështetëse të Komisionit të Përkohshëm, ka përfunduar dhe dorëzuar pranë Komisionit, 19 (nëntëmbëdhjetë) projektraporte⁶ të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtarë të shkallëve të para si dhe gjyqtarë apelit

Referuar mendimit të strukturës përgjegjëse organizative, rezulton se përgatitja e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale, është një proces që kërkon realizimin e shumë veprimeve deri në finalizimin e tij dhe gjyqtari i komanduar, {...}, ka shfaqur gjithnjë një përkushtim maksimal gjatë procesit të hartimit të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale dhe jo vetëm.

Përgatitja e projektraportve është kryer në respektim të parashikimeve të: Ligjit Nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me përcaktimet e Rregullores: "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional dhe të Aneksëve si pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje, akt i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 24, datë 07.02.2019⁷.

Gjyqtari i komanduar, në raportin përshkruar të punës, referon se, në hartimin e projektraporteve profesionale të subjekteve të rivlerësimit, para hyrjes në fuqi të Rregullores së miratuar nga KLGJ-ja me Vendimin Nr. 24, datë 07.02.2019, ka ndjekur dhe zbatuar formatin standard, kushtet dhe kriteret e parashikuara në Vendimin Nr. 49, datë 16.10.2017, të miratuar nga Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Puna e tij, në mënyrë kronologjike ka ndjekur këto hapa:

- (i) pas marrjes me short të dosjes së rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, gjyqtari i komanduar, menjëherë, ka verifikuar saktësinë e të dhënave statistikore për çështjet e gjykuara nga subjekti në periudhën 08.10.2013-08.10.2016, të dhëna të dërguara nga gjykata ku ai ka ushtruar funksionin gjatë kësaj periudhe rivlerësimi;
- (ii) nëse të dhënat statistikore kanë rezultuar me mangësi, nëpunësi përgjegjës në bashkëpunim të ngushtë me stafin përkatës dhe ndihmës të KLGJ-së, ka kërkuar nga gjykata respektive ndreqjen e gabimeve në tabelat statistikore duke i ripunuar ato;
- (iii) në procesin e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e pesë dosjeve, gjyqtari i komanduar {...}, ka treguar angazhim maksimal në mbajtjen e saktë të procesverbalit të shortit, por edhe duke u kujdesur që përzgjedhja e pesë dosjeve të kryhet duke respektuar rigorozisht kriteret e përzgjedhjes të parashikuara në Aneksët e Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve";

⁶ raportet profesionale të përgatitura nga nëpunësi përgjegjës pranë Komisionit të Përkohshëm, z. {...} për periudhën 01.01.2019- 01.06.2020

⁷ Raport përshkruar vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}

- (iv) pas hedhjes së shortit, gjyqtari i komanduar është kujdesur në bashkëpunim me stafin ndihmës të këtij procesi, për tërheqjen e pesë dosjeve pranë gjykatave ku ato ndodhen ;
- (v) pasi janë siguruar dosjet, por edhe të dhënat nga Burimet Njerëzore dhe Arkivore të KLGJ-së, gjyqtari i komanduar ka vijuar punën për hartimin e projektraportve, ku në varësi të kompleksitetit të çështjeve objekt trajtimi, procesi merr mesatarisht tre deri në katër javë kohë. (ky afat, nga momenti i paraqitjes në Këshill të dosjes së fundit përcjellë nga gjykatat);
- (vi) projektraporti pas hartimit nga gjyqtari i komanduar, i nënshtrohet kontrollit nga Relatori dhe më pas nga Komisioni i Përkohshëm. Pas miratimit prej tyre, raporti i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga burimet e vlerësimit, rezulton se, në hartimin e projektraportve, gjyqtari i komanduar {...}, ka përgatitur me përparësi dhe në përputhje me udhëzimin e Komisionit të Përkohshëm, raportet që i përkasin subjekteve e të cilëve janë kërkuar me urgjencë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Në hartimin e projektraportve, gjyqtari i komanduar ka treguar një përkushtim të lartë, me qëllim që projektraportet profesionale, të përfundohen në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, por kurrsesi pa cënuar cilësinë e përmbajtjes së tyre.

Bazuar në Raportin përshkrues statistikor të hartuar nga gjyqtari i komanduar {...}, rezultoi se ai përveç hartimit të projektraportve profesionale, ka kryer edhe detyra të tjera të cilat i janë ngarkuar atij nga struktura eprore administrative.

Kështu, gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, rezultoi se z. {...}, ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor në 8 (tetë) procese gjyqësore⁸ ku Këshilli ka qenë palë e paditur. Padiësit kundërshtonin me padi vendimarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për skualifikimin e tyre nga gara për në Gjykatën e Lartë, si kandidatura të ardhura nga jashtë sistemit gjyqësor.

Në ato procese gjyqësore, ka përgatitur prapësimet por edhe konkluzionet me shkrim, duke realizuar një mbrojtje profesionale dhe efektive përpara gjykatës.

Rezultoi gjithashtu, se gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, z. {...}, ka marrë pjesë në dy grupe pune të ngritura me urdhër të posaçëm nga Kryetarja e KLGJ-së⁹:

Bazuar në përmbajtjen e raportit përshkrues statistikor, z. {...}, është ngarkuar nga titullarja i KLGJ-së, edhe me kryerje të detyrave të tjera, të cilat përshkruhen hollësisht prej tij në raportin përshkrues të punës të hartuar nga vetë gjyqtari i komanduar.

⁸ 1. Agron Lamaj, sipas autorizimit Nr. 4949/2 prot., datë 10.10.2019 ; 2. Ergys Misha, sipas autorizimit Nr. 4999/2 prot., datë 11.10.2019 ; 3. Altin Binaj, sipas autorizimit Nr. 4966/1 prot., datë 10.10.2019 ; 4. Jordan Daci, sipas autorizimit Nr. 4866 prot., datë 04.10.2019 ; 5. Jordan Daci, sipas autorizimit Nr. 4859/6 prot., datë 04.11.2019 ; 6. Theodhori Sollaku, sipas autorizimit Nr. 5665/2, datë 19.11.2019 ; 7. Florin Demollari, sipas autorizimit Nr. 6068/2, datë 11.12.2019 ; 8. Emiljano Shullazi, sipas autorizimit Nr. 1052/2, datë 10.02.2020 dhe 8. Emiljano Shullazi, sipas autorizimit Nr. 1702/2, datë 06.05.2020.

⁹ Me Urdhërin nr. 135, datë 10.04.2019, ka kontribuar “Për hartimin e projekt-raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2018”, me Urdhërit Nr. 12, datë 28.01.2020, ka kontribuar “Për hartimin e projektraportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2019.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm të titullares, si dhe në funksion të ndarjes së detyrave midis pjesëtarëve të Grupit të Punës, rezulton se Z. {...}, ka përgatitur raportin lidhur me veprimtarinë e Nëpunësve Përgjegjës të Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, përsa i takon procesit të hartimit të raporteve profesionale për subjektet e rivlerësimit kalimtar (gjyqtarëve) për llogari të procesit të Rivlerësimit kalimtar (Vetting). Në pjesën e raportit të punuar prej tij si pjesëtar i grupit të punës, janë paraqitur të dhëna të hollësishme për numrin e subjekteve të rivlerësimit për të cilat është përfunduar hartimi i raportit të analizimit të aftësive profesionale dhe etike, sipas gjykatave ku këto subjekte kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit, rezultatet e kriterit të vlerësimit profesional dhe etik të tyre, problematikat e hasura në proceset e shortimit etj

Gjithashtu, gjyqtarit të komanduar {...} i janë caktuar edhe detyra të tjera nga titullarja e Këshillit¹⁰. Në përfundim të zbatimit të urdhrave të mësipërm, nga ana e gjyqtarit të komanduar dhe bashkëpunëtorëve të përfshirë në urdhër janë hartuar relacionet me shkrim lidhur me të gjitha të dhënat e evidentuara, si dhe me një analizë ligjore të rezultateve të konstatuara. Raportet i janë dorëzuar titullares së KLGJ-së.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera të përshkruara më sipër si pjesëmarrja në grupe pune, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar për të realizuar ngarkesën e punës vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

2.A.b Aftësia për të respektuar afatet

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit.

¹⁰ Me urdhërin nr. 156, datë 06.05.2019 “mbi grumbullimin e informacionit dhe akteve respektive mbi veprimtarinë e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; Urdhërin Nr. 2, datë 08.01.2020 mbi grumbullimin e informacionit dhe akteve respektive mbi rastin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë ndaj gjyqtarit Enkeleida Hoxha e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; Urdhërin Nr. 23, datë 10.02.2020 mbi inventarizimin dhe regjistrimin e të gjitha të dhënave dhe praktikave (ankesave) të evidentuara sipas memos datë 25.07.2019, të cilat ndodhen në zyrën e Arkiv Protokollit, në KLGJ.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Nëpunësi përgjegjës {...}, ka treguar përkushtim maksimal, për të përmbushur në kohën e duhur detyrat që i janë caktuar. Në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale, z. {...}, ka respektuar në çdo rast afatet e parashikuara në aktet nënligjore të nxjerra nga KLGJ-ja, por edhe afatet specifike të caktuara në detyrat e tjera që ai është ngarkuar të kryejë. Nuk është konstatuar asnjë problematikë në këtë aspekt të veprimtarisë profesionale të nëpunësit përgjegjës {...}”*.
- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit, dhe situatës faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre, gjyqtari i komanduar ka realizuar në kohë reale dhe afate të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore detyrat e ngarkuara për trajtim, mbështetur në të dhëna të konstatuara”*.
- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se; *Theksoj, se të gjitha detyrat që më janë caktuar nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative të KLGJ-së, i kam kryer me profesionalizëm të lartë, por edhe në respektim të plotë të afateve kohore të parashikuara nga ligjet në fuqi, aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të ligjit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjithashtu, në çdo rast, kam përmbushur brenda afatit, detyrat e ngarkuara nga struktura përgjegjëse organizative apo administrative, detyra të përcaktuara në urdhërin përkatës të nxjerrë nga struktura përgjegjëse.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar Z.{...}, në hartimin e projektraporteve i ka dhënë përparësi atyre subjekteve, për të cilat ka patur kërkesë urgjente nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit duke bërë përpjekje maksimale që projektraportet e analizimit të aftësive profesionale, të përfundohen brenda një kohe sa më të shpejtë dhe të arsyeshme, por duke mos neglizhuar në asnjë rast cilësinë e përmbajtjes së raportit.

Gjyqtari i komanduar {...}, ka treguar përkushtim maksimal, për të përmbushur në kohën e duhur detyrat që i janë caktuar. Në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale, z. {...}, ka respektuar në çdo rast afatet e parashikuara në aktet nënligjore të nxjerra nga KLGJ-ja, por edhe afatet specifike të caktuara në detyrat e tjera që ai është ngarkuar të kryejë.

Rezultoni se nuk është konstatuar asnjë problematikë në këtë aspekt të veprimtarisë profesionale të nëpunësit përgjegjës {...}.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të për respektuar afatet parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo atyre të caktuara apo sipas rastit e natyrës së punës. Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtari i komanduar ka aftësi shumë të mira për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që i janë caktuar për trajtim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Aftësia për të respektuar afatet”, aftësia e gjyqtarit të komanduar vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

2.B Efektiviteti dhe metodologjia

2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit së komanduar, gjyqtarji vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Konstatohet se eksperiencia e gjatë si gjyqtar i komanduar, i jep mundësinë nëpunësit përgjegjës {...}, që të jetë mjaft efektiv në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprorë. Sapo njihet me detyrën që i është ngarkuar të kryejë, ai, e ka mjaft të qartë se cilat veprime duhen kryer, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre. Është në gjëndje të dallojë çështjet, trajtimi i të cilave ka përparësi/ujencë dhe të marrë masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme. Kur ka marrë pjesë në grupe pune, ka bashkëvepruar me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga Urdhëri përkatës i nxjerrë nga struktura eprorë”*.
- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit është shprehur shumë e lartë aftësia për veprime procedurale, në shfrytëzim të kohës, burimeve në dispozicion, si dhe aftësia organizative”*.
- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke argumentuar se: *“Në lidhje me këtë tregues, vlerësoj se kam treguar aftësi shumë të mira metodologjike, duke qënë i qartë për detyrën që më është ngarkuar. Menaxhoj si duhet kohën*

dhe burimet e tjera në dispozicion në funksion të saktësisë së veprimeve procedurale që duhet kryer. Në çështjet që më janë caktuar për trajtim, kam shfaqur prirjen për të identifikuar thelbin e çështjes”

Edhe lidhur me këtë tregues gjyqtari nuk ka bërë komente apo kundërshtime për vlerësimet e kryera nga struktura përgjegjëse organizative dhe ajo administrative, duke u shprehur dakord me vlerësimin e kryer.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi rezulton se Z. {...} ka një eksperiencë të gjatë si gjyqtar i komanduar, fakt që i jep mundësinë që të jetë mjaft efektiv në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprore. Rezulton se gjyqtari i komanduar i ka mjaft të qarta veprimet që duhet të ndërmerret kur njihet me detyrën që i është ngarkuar të kryejë, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre.

Gjyqtari i komanduar është në gjendje të dallojë çështjet, trajtimi i të cilave ka përparësi/ugjencë dhe të marrë masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme.

Gjithashtu, kur ka marrë pjesë në grupe pune, ka bashkëvepruar me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga urdhrat përkatës të nxjerrë nga struktura eprore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe burimet e tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës, duke evidentuar çështjet që kanë përparësi trajtimi si dhe ato me probleme procedurale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në treguesin “Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

2.C Rregullshmëria dhe saktësia

2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Nëpunësi përgjegjës {...}, si në rastin e hartimit të projektraportve profesionale, ashtu edhe gjatë kryerjes së detyrave të tjera të ngarkuara nga strukturat drejtuese të KLGJ-së, është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar. Dokumentacioni pas përfundimit të punës që i është ngarkuar, është dorëzuar i plotë dhe në afatin e përcaktuar pranë strukturës kompetente”*.
- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit”* si shumë të larta duke deklaruar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit është shprehur aftësi shumë e lartë rregullësie dhe saktësie në përpilim të dokumentacioneve, të cilat kanë qenë të shfrytëzueshme nga struktura kompetente”*.
- Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se; *Në lidhje me këtë tregues, kam shfaqur aftësi të larta në mbajtjen e rregullt të dokumentacionit të përpunuar prej meje, si atë që lidhet me hartimin e Projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale, por edhe të çdo dokumentacioni tjetër që lidhet me çështjet e tjera të cilat më janë caktuar për trajtim nga strukturat përgjegjëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Duke ju referuar burimeve të vlerësimit konstatohet se aktet e dosjeve të trajtuara prej meje janë të plota dhe të sakta në aspektin formal. Nuk ka rezultuar në asnjë rast mungesë dokumentacioni dhe as prania e akteve që nuk kanë lidhje me çështjen respektive”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar {...}, si në rastin e hartimit të projektraporteve profesionale, ashtu edhe gjatë kryerjes së detyrave të tjera të ngarkuara nga strukturat drejtuese të KLGJ-së, është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar. Dokumentacioni pas përfundimit të punës që i është ngarkuar, është dorëzuar i plotë dhe në afatin e përcaktuar pranë strukturës kompetente.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta në renditjen e akteve dhe rregullshmërisë së dokumentacionit (fizik apo elektronik) të administruar, dokumentacion që gjyqtari i komanduar i përcjell strukturës përgjegjëse ku ai shërben sipas rastit ose strukturave të tjera të Këshillit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: “Rezulton se në dosjet që ju përkasin projekt-raporteve profesionale, nëpunësi përgjegjës {...}, ka administruar, mbajtur dhe mbikqyrur me mjaft kujdes dokumentacionin, aktet shkresore që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet që kanë shërbyer për përpilimin e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale. Aktet e dosjes kanë qënë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit”.
- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: “Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit, dokumentacioni i hartuar dhe përgatitur ka qënë konkret, referuar për sa është kërkuar për trajtim”
- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se “...Në dosjet që ju përkasin projekt-raporteve profesionale, kam administruar, mbajtur dhe mbikqyrur me mjaft kujdes dokumentacionin, aktet shkresore që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet që kanë shërbyer për përpilimin e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale. Aktet e dosjes kanë qënë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Gjithashtu, i njëjti kujdes nga ana ime, është treguar edhe në lidhje me dokumentacionin që i përket çështjeve të tjera të trajtuara prej meje në kuadër të detyrave të ngarkuara nga struktura përgjegjëse administrative”. Lidhur me këtë tregues, gjyqtari nuk ka parashtuar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar {...}, ka administruar, mbajtur dhe mbikqyrur me mjaft kujdes dokumentacionin, aktet shkresore që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet që kanë shërbyer për përpilimin e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale. Aktet e dosjes kanë qënë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) i përcjellë strukturës përgjegjëse ku ai shërben apo strukturave të tjera të Këshillit, të jetë i plotë dhe t’i përkasë çështjes konkrete në trajtim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA ORGANIZATIVE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;

- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD;
- Të dhënat e raporteve të ILDKPKI.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Lidhur me këtë aspekt, në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative, konkludohet se:** Nëpunësi përgjegjës {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka respektuar maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, por edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi por edhe përtej saj, pra deri më sot, nuk rezulton që në adresë të tij, të jetë regjistruar ndonjë ankesë për mosrespektim të etikës, si nga eprorët, kolegët, stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga subjektet e rivlerësimit apo nga çdo person tjetër. Respektimi i normave të etikës prej tij është vlerësuar dhe kuptuar, jo vetëm si një detyrim që duhet zbatuar gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë kohës së ushtrimit të saj.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”,** lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: “Gjyqtari i komanduar gjatë periudhës së vlerësimit ka shprehur dhe zbatuar në shkallë të lartë parimet e etikës, komunikimit, transparencës”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke argumentuar se “ Vlerësoj se gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar i komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kam respektuar maksimalisht normat etike si dhe normat e sjelljes, në raport me eprorët, kolegët e mi, stafin administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor, subjektet e rivlerësimit, por edhe ndaj çdo zyrtari tjetër shtetëror me të cilin kam patur kontakte pune. Respektimi i normave të etikës prej meje, është vlerësuar jo vetëm si një detyrim që duhet zbatuar gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë kohës së ushtrimit të saj, pra edhe në jetën e përditshme në raport me të afërmit, miqtë e mi, si dhe me çdo qytetar. Referuar dokumentacionit burim vlerësimi nuk rezulton të jenë evidentuar element që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve prej meje që tregojnë mungesë respekti, vëmëndje apo prani e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofenduese nga ana ime gjatë ushtrimit të detyrës. Pra, vlerësoj se kam treguar shkallë të lartë angazhimi dhe përgjegjegjshmërie në ushtrimin e detyrës. Edhe lidhur me këtë tregues, gjyqtari nuk ka parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, duke u shprehur dakord me vlerësimin e bërë nga strukturat përgjegjëse.

➤ Referuar informacionit të dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me nr. 1434/1 prot, datë 11.05.2023, protokolluar në KLGJ me shkresën nr. 2640/3 prot, datë 12.05.2023 në lidhje me verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtarit {...}, rezulton se në ILD nuk është depozituar asnjë ankesë ndaj Z. {...} për periudhën e vlerësimit. Gjithashtu, për këtë periudhë, në ILD nuk është depozituar asnjë masë disiplinore nga organet kompetente.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka respektuar maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, por edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, por jo vetëm, nuk rezulton që në adresë të tij, të jetë regjistruar ndonjë ankesë për mosrespektim të etikës, si nga eprorët, kolegët, stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga subjektet e rivlerësimit apo nga çdo person tjetër. Respektimi i normave të etikës prej tij është vlerësuar dhe kuptuar, jo vetëm si një detyrim që duhet zbatuar gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë kohës së ushtrimit të saj.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cënojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtarit të komanduar

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD;
- Të dhënat e raporteve të ILDKPKI.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”, lidhur me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Mund të themi se, në detyrat që i janë ngarkuar për të kryer, nëpunësi përgjegjës {...}, ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e gjyqtarit. Nuk konstatohet asnjë rast, ku nëpunësi përgjegjës {...}, të ketë shfaqur anësi në vlerësimin e subjekteve*

të rivlerësimit, apo të ketë favorizuar ose paragjykuar ndonjë prej tyre. Nuk është konstatuar asnjëherë, një sjellje jokorrekte apo e pahijshme e tij gjatë ushtrimit të detyrës. Profesionalizmi, ndershmëria, përgjegjshmëria, respekti dhe vlerësimi për të tjerët, humanizmi, janë tipare thelbësore të karakterit të nëpunësit përgjegjës {...}”.

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar për periudhën e vlerësimit ka shfaqur dinjitet të lartë duke ndjekur dhe zbatuar parimin e bashkëpunimit, me dinjitet, përgjegjshmëri dhe me vlera të larta personale”*
- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se *“Në lidhje me këtë tregues, gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar i komanduar, vlerësoj se kam demonstruar një shkallë të lartë integriteti, duke shfaqur ndershmëri, dinjitet dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e kësaj detyre. Nuk konstatohet asnjë rast që gjatë ushtrimit të detyrës të kem favorizuar ose të kem vlerësuar me anshmëri subjektet e rivlerësimit në hartimin e projektraportve të aftësive profesionale. Në periudhën objekt vlerësimi ndaj meje nuk është adresuar asnjë ankesë nga subjektet e rivlerësimit apo subjekte të tjera. Po ashtu, ndaj meje nuk ka patur asnjë rast për fillimin e procedurave disiplinore. Edhe lidhur me këtë tregues, gjyqtari është shprehur dakord me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, duke mos parashtruar asnjë kundërshtim.*
- Referuar informacionit të dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rezulton se për periudhën 01.01.2019- 01.06.2020, ndaj gjyqtarit {...}, nuk rezulton të jetë paraqitur ankesë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Po kështu, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtarin {...} nuk është dhënë asnjë e tillë.
- Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 231/23 prot. datë 03.02.2021, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, rezulton se: *a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; ç) nuk ka kryer deklaram të rremë; d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se në detyrat që i janë ngarkuar për të kryer gjyqtarit të komanduar, ai ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e gjyqtarit dhe nuk konstatohet në asnjë rast, të ketë shfaqur anësi në vlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, apo të ketë favorizuar ose paragjykuar ndonjë prej tyre.

Nuk është konstatuar asnjëherë, një sjellje jokorrekte apo e pahijshme e tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit si dhe parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari i komanduar duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi rezulton se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit e gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtarit të komanduar

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”,** lidhur me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Në përmbajtjen e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale dhe jo vetëm, nëpunësi përgjegjës {...}, në asnjë rast nuk ka dhënë konsiderata personale, por ka mbajtur qëndrime tërësisht profesionale. Në aktet e përgatitura prej tij, tregohet kujdes në zgjedhjen e fjalëve dhe fjalive, duke shmangur çdo lloj fjale apo fjalie të papërshtatshme, me natyrë diskriminuese apo paragjykuese. Në projektraportet profesionale por dhe në dokumentat e tjera të përgatitura prej tij, në zbatim të urdhërave të nxjerrë nga Titullari i Institucionit, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa për njënashmëri në përmbushjen e detyrës. Në asnjë nga dokumentat e përgatitura prej tij, nuk konstatohet përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë, që të vënë në dyshim pananësinë e tij në ushtrimin e detyrës.”.*

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar për periudhën e vlerësimit është mbështetur në parimet bazë të komunikimit, duke mos qenë diskriminues”*.

Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtari të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se *“Nuk konstatohet asnjë rast që gjatë ushtrimit të detyrës të kem shfaqur paragjykime racore, ngjyre, seksi, moshe, gjinie, në komunikim ose në hartimin e projektraportve të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, apo edhe në përmbajtje të çdo dokumenti tjetër të përpiluar prej meje në kuadër të detyrave të caktuara nga strukturat e tjerë përgjegjëse të KLGJ-së. Nuk rezulton në asnjë dokument të përgatitur prej meje përdorimi i gjuhës diskriminuese, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, po ashtu edhe sa i takon komunikimit verbal i cili ka qenë gjithnjë mjaft korrekt”*. Edhe lidhur me këtë tregues, gjyqtari është shprehur dakord për vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, duke mos parashtruar asnjë koment lidhur me të.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar {...} në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e projektraportve apo dokumentave të tjerë të hartuar prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari i komanduar vlerësohet se ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit e gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Rezultoi se nëpunësi përgjegjës {...}, gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional dhe etik (01.01.2019-01.06.2020), në asnjë rast, nuk ka kërkuar të heqë dorë nga kryerja apo përmbushja e një detyre që atij i është ngarkuar nga eprorët apo nga strukturat përgjegjëse organizative apo administrative”*.
- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar për periudhën e vlerësimit, nuk ka refuzuar heqjen dorë nga trajtimi i procedurave administrative, në përputhje edhe me parimin e paanshmërisë”*.

Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se; *“Referuar të dhënave të rezultuara nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, konstatohet se nuk ka patur asnjë rast, ku prej meje të jetë kërkuar heqja dorë nga kryerja e një detyre që më është caktuar nga struktura përkatëse organizative apo administrative. Gjithashtu, nuk evidentohet asnjë rast ku të jem përjashtuar nga kryerja e ndonjë detyre të ngarkuar prej strukturave përgjegjës”*.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezultoi se gjyqtari i komanduar {...}, gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional dhe etik, në asnjë rast, nuk ka kërkuar të heqë dorë nga kryerja apo përmbushja e një detyre që atij i është ngarkuar nga eprorët apo nga strukturat përgjegjëse organizative apo administrative.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar për përjashtim si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative është *“I pakonsiderueshëm”*, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk është kërkuar asnjëherë përjashtimi i tij sidhe nuk ka hequr dorë nga asnjë procedurë administrative.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin *“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative”*, vlerësohet se ky numër është *“I pakonsiderueshëm”*, dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Rezultoi se nëpunësi përgjegjës {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim tejet korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së. Komunikimi i tij karakterizohet nga përdorimi i fjalëve dhe fjalive të thjeshta, të qarta, duke shmangur përdorimin e fjalëve dhe fjalive që krijojnë keqkuptime, paqartësi apo kuptime të shumëfishta. Shfaq atësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e bashkëbiseduesit, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me të. Në çdo rast, komunikimi i tij, ka qënë në respektim të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civile.*
- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka shfaqur komunikim shumë të lartë. Ka qënë i qartë, kuptueshëm dhe transparent”.*
- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Referuar burimeve të rivlerësimit konstatohet se gjatë ushtrimit të detyrës kam shfaqur aftësi të larta për të komunikuar qartë, thjeshtë, me etikë, duke shmangur në çdo rast përdorimin e fjalëve fyese, të papërshtatshme, të paqarta, apo fjalive që krijojnë*

keqkuptime ose kuptime të dyfishta. Referuar dokumentave ligjore të hartuara prej meje gjatë ushtrimit të detyrës, rezulton nga përmbajtja e tyre shprehja e qartë, transparente, e saktë, konçize dhe e drejtpërdrejtë e mendimit juridik, duke respektuar normat e shkrimit ligjor”.

Referuar burimeve të vlerësimit rezultoi se gjyqtari i komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim tejet korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së.

Komunikimi i tij karakterizohet nga përdorimi i fjalëve dhe fjalive të thjeshta, të qarta, duke shmangur përdorimin e fjalëve dhe fjalive që krijojnë keqkuptime, paqartësi apo kuptime të shumëfishta. Ai shfaq atësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e bashkëbiseduesit, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me të.

Gjithashtu në çdo rast, komunikimi i tij, ka qënë në respektim të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civile.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari i komanduar në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Rezulton se nëpunësi*

përgjegjës {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka treguar kujdesin maksimal për të përmbushur detyrimet ligjore, lidhur me respektimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit, sa i takon të dhënave personale që ju përkasin subjekte të rivlerësimit, por edhe kategorive të tjera të zyrtarëve shtetërorë me të cilët është ndeshur në përmbushje të detyrave të tjera që i janë ngarkuar atij nga strukturat drejtuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka respektuar parimin e konfidencialitetit duke ruajtur në mënyrë koncize çdo të dhënë konfidenciale”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konstatohet se nuk ekziston asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale, prandaj vlerësoj se kam treguar kujdes maksimal për ruajtjen e të dhënave personale të subjekteve të rivlerësimit, për të cilat kam ardhur në dijeni për shkak të funksionit që kryej. »*

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari {...} ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të procedimit apo vlerësimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari i komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;

- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Rezulton se nëpunësi përgjegjës {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, është treguar i gatshëm të bashkëpunojë me kolegët gjyqtarë të komanduar në KLGJ, duke shkëmbyer me ta njohuri dhe përvojën e tij profesionale. Komunikimi i tij me kolegët ka qënë gjithmonë i hapur dhe i sinqertë. Një komunikim dhe bashkëpunim korrekt ai rezulton të ketë patur edhe me stafin administrativ të KLGJ-së, si në rastin e përfaqësimit të KLGJ-së në procese gjyqësore, ashtu edhe në bashkëpunimet që ka patur në Grupet e Punës të ngritura me urdhër të Titullarit të KLGJ-së.”.*

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka shfaqur bashkëpunim dhe etikë, duke shkëmbyer përvojë profesionale”.*

Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se: *“Rezulton referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, se aftësia ime për të bashkëpunuar me kolegët ka qënë në nivele të larta”.*

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

4.B.b Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarit është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka qenë bashkëpunues, i gatshëm dhe efektiv edhe në detyra të ngarkuara edhe në pjesëmarrje në grupe pune duke dhënë kontributin maksimal”*.

- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se: *“Krahas kryerjes së detyrës në lidhje me hartimin e projekt-raportve profesionale, mbështetur në aktet e përfaqësimit të nxjerra nga Titullari i KLGJ-së, kam marrë pjesë në përfaqësimin e KLGJ-së në tetë procese gjyqësore ku ajo është thirrur si palë e paditur. Kam përgatitur prapësime me shkrim por edhe konkluzione me shkrim, duke siguruar një mbrojtje ligjore dhe dinjitoze të vendimarrjeve të KLGJ-së të kontestuara në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjithashtu, kam marrë pjesë në Grupe Pune të ngritura me urdhër të Titullarit të KLGJ-së, ku kam dhënë ndihmesën time profesionale në përmbushje të detyrave të caktuara nëpërmjet urdhërit përkatës. Kam ndarë detyrat me pjesëtarët e tjerë të grupit, por edhe kam bashkëpunuar ngushtësisht me ta për përmbushjen e detyrave të caktuara në urdhërin përkatës.*

Referuar burimeve të vlerësimit, sikurse u përmend edhe më lart, rezulton se gjyqtari i komanduar {...}, krahas kryerjes së detyrës në lidhje me hartimin e projektraportve të vlerësimit profesional të gjyqtarëve gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, ka përfaqësuar KLGJ-në në tetë procese gjyqësore ku ajo është thirrur si palë e paditur si dhe ka përgatitur prapësimet dhe konkluzionet me shkrim.

Gjithashtu, gjyqtari i komanduar ka marrë pjesë në grupe pune të ngritura me urdhër të titullarit të KLGJ-së, ku ka dhënë ndihmën e tij profesionale në përmbushje të detyrave të caktuara nëpërmjet urdhërit përkatës etj.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë një deri 2 (dy) pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarit të komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, vlerësohet se aftësia e tij në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Rezulton se nëpunësi përgjegjës {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, në asnjë rast nuk ka krijuar situata konflikti. Bashkëpunimi i tij me eprorët, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me gjyqtarët e tjerë të komanduar dhe stafin administrativ të KLGJ-së ka qënë në nivele të larta”.*
- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka qënë shumë bashkëpunues me strukturat funksionale, duke ofruar zgjidhje të mundshme me shfaqje të etikës profesionale”.*
- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se: *“Referuar të dhënave të rezultuara nga raportet vlerësuese të strukturave përgjegjëse, rezulton se gjatë ushtrimit të detyrës, në asnjë rast nuk kam krijuar apo të përfshihem në situata konflikti apo të papërshtatshme dhe në kundërshtim me detyrën. Në asnjë situatë nuk e kam vendosur veten në konflikt me ligjin dhe normat e etikës. Bashkëpunimi im me eprorët, kolegët, stafin administrativ të KLGJ-së ka qënë në nivele të larta”.*

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari i komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, në asnjë rast nuk ka krijuar situata konflikti. Bashkëpunimi i tij me eprorët, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me gjyqtarët e tjerë të komanduar dhe stafin administrativ të KLGJ-së ka qënë në nivele të larta.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e aftësisë për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë, është shumë e lartë. Gjyqtari i komanduar është treguar i gatshëm të japë kontributin e tij në raste të shfaqjes së

problemeve apo vështirësive gjatë punës, duke ruajtur qetësinë, etikën dhe duke synuar zgjidhjen e menjëhershme dhe efektive të konfliktit. Gjyqtari i komanduar ka ndërtuar marrëdhënie korrekte me anëtarët e këshillit, strukturat drejtuese dhe të gjithë administratën.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

4.C Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar” gjyqtari ka deklaruar se: “Kam përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 76 të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, duke marrë pjesë në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës. Përgjatë periudhës 01.01.2019-01.06.2020, kam marrë pjesë në 11(njëmbëdhjetë) trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe në të cilat kam patur ftesë pjesëmarrja nga ajo shkollë. Nuk kam patur mundësi për pjesëmarrje më të shpeshta në trajnime, për shkak të ngarkesës së lartë që kam patur në punën e përditshme...”

➤ Nga të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se gjyqtari {...} ka qenë në cilësinë e pjesëmarrëses në 11 (njëmbëdhjetë) aktivitete, të zhvilluara gjithsej në 19 ditë kalendarike.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 11 aktivitete të zhvilluara për 19 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare, megjithëse ai po vlerësohet për një periudhë prej rreth 1 vit e gjysmë, duke qenë kështu edhe brenda kufijve të përcaktuar për këtë periudhë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit të komanduar në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve, dhe për pasojë pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari ka deklaruar se: *“Deklaroj se gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, nuk kam marrë pjesë në cilësinë e ekspertit apo lehtësuesit në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera. Detyra e kryer si Nëpunës Përgjegjës pranë Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Subjekteve të Rivlerësimit, lidhet drejtpërsëdrejti me vlerësimin e aftësive profesionale dhe etike të magjistratëve(gjyqtarëve).”*

Referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton se gjyqtari i komanduar të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit.

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe një deri në dy pikë të tjera iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin e komanduar {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari i komanduar nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues apo ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit të komanduar dhe për pasojë pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari ka deklaruar se: *“Nuk kam patur ftesa për të marrë pjesë në aktivitete ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional.*

Referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton se gjyqtari i komanduar të ketë marrë pjesë në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, vlerësimi për këtë tregues fillon me 3 pikë dhe një ose dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim atyre që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë si të komanduar, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burimet e vlerësimit të këtij treguesi.

Në këto kushte, vlerësoj se për gjyqtarin e komanduar {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari i komanduar nuk ka marrë pjesë në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në lidhje me treguesin “Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit të komanduar dhe për pasojë pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari ka deklaruar se: *“Nuk jam angazhuar në botime juridike gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi”*.

Referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton se gjyqtari i komanduar të ketë bërë publikime ligjore akademike.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, konsiderohen vlerë e shtuar për gjyqtarin e komanduar publikimet ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës. 1 deri 5 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku përfshihen artikuj, kapituj, monografi, ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Në këto kushte, vlerësoj se për gjyqtarin e komanduar {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari i komanduar nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarit, dhe për pasojë pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësia profesionale	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësia organizative	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tij për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT TË KOMANDUAR**

{...}

PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 01.01.2019 – 01.06.2020

			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
1. AFTËSIA PROFESIONALE			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë : E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë : E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë : E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë

		3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit			Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSIA ORGANIZATIVE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës	a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative; 4. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

	b. Aftësia për të respektuar afatet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative; 4. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Efektiviteti dhe metodologjia	a. Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative; 4. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
C. Rregullshmëria dhe saktësia	a. Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative; 4. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative; 4. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë - 15 pikë	
1. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE					Pikët total	Niveli i vlerësimit
					100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni i marrë nga ILD (rezultatet e verifikimit të ankesave) 2. Dosja personale e gjyqtarit (masat disiplinore...etj) 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 5. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative; 	Shumë e lartë	35	Shkalla e aftësisë: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë	

<p>B. Integriteti i gjyqtarit</p>	<p>a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni i marrë nga ILD (rezultatet e verifikimit të ankesave) 2. Dosja personale e gjyqtarit (masat disiplinore...etj) 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 5. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative 6. Raporti i ILDKPKI 	<p>Shumë e lartë</p>	<p>40</p>	<p>Shkalla e integritetit: E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë</p>
<p>C. Paanësia e gjyqtarit</p>	<p>a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative 	<p>Shumë e lartë</p>	<p>10</p>	<p>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë</p>

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
1. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë

		administrative			
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative 	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 4 deri 5 pikë
	c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të tjera të dorëzuara nga gjyqtari 	01.01.2019-01.06.2020	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4 (periudha 5/vjeçare) 30-200 ditë – 20 pikë <30 ose > 200 ditë: 4

	b. Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 4 deri 5 pikë
	c. Pjesëmarrja në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Çdo e dhënë tjetër që provon angazhimin dhe kontributin konkret	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 4 deri 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			391		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqyeshëm		

